

NJOFTIM

MBI KRITERET E PRANIMIT TË KANDIDATËVE PËR STUDIME NË AFA

- të jetë shtetas shqiptar;
- të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- të mos jetë në ndjekje penale;
- të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata;
- të mos ketë probleme me deportimin;
- të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera;
- të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimitari të kundraligjshme apo kriminale;
- në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (01 shtator 2023). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (01 shtator 2023);
- të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;
- të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit;
- të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së;
- të plotësojë kushtin e sigurisë;
- të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi bechelor) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë);
- të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkokë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike;
- të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjisacionit në fuqi.
- Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kritereve të cituara më sipër duhet:
 1. të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”;
 2. të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE, DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

- kërkesë me shkrim;
- formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A;
- fotokopje e kartës së identitetit;
- fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën
 - e notave të lëndëve;
- fotografji për dokument (4x6), 2 copë;
- formularët e vetëdeklarimit;
- raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit.
- analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bankat e gjakut apo drejtoretë e Shëndetit Publik në rrjetet ku banojnë.